

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Personalisht nuk do ta besoja kurrë se midis parlamentarëve të republikës sonë do të kishte një të atillë, që të jetë kundër investimeve, aq më tepër kundër investimeve të këtyre përmasave. Do të ishte njësoj sikur të gjendej mes shkretëtirës dhe të refuzonte dikë që i ofronte dy pika ujë. Personalisht jam pro investimeve të biznesmenit të njohur për investime të përmasave të mëdha nga Emiratet e Bashkuara. Personalisht jam pro forcimit të marrëdhënieve politike dhe ekonomike me Emiratet e Bashkuara, por Emiratet e Bashkuara janë monarki, ndërsa ne jemi republikë parlamentare. Zgjedhja e tyre është ajo, zgjedhja jonë është kjo.

Vendimet atje i marrin monarkët, në republikën parlamentare, në demokraci, i marrin institucionet e përcaktuara nga ligji në bazë të normave dhe procedurave qartësisht të përcaktuara. Pse e theksoj këtë gjë? E theksoj, sepse ne jemi duke vendosur me procedurë të përshpejtuar për projektin më të madh financiar të realizuar ndonjëherë. Projekti më i madh me procedurë të përshpejtuar. Oksimoron do të mund ta karakterizojmë. Ky projektligj është më i rëndësishëm se buxheti i shtetit dhe duhet ta shteronim nga çdo këndvështrim dhe në çdo aspekt, që të mos mbetet asnjë lloj hije. Kryeministri sot, me shumë pasion, duke kapërcyer çdo normë etike, në një përpjekje të dështuar, mbronte investitorin dhe vendin e tij të origjinës.

Nëse do të donte realisht t'i bënte nder investitorit me mbrojtje publike, nuk do të përdorte epitete, metafora dhe hiperbola, por do të përdorte vetëm shifra dhe fakte dhe nuk e bëri. Zonja dhe zotërinj, Çfarë do të ndodhte në një vend të civilizuar nëse do të kishte një hapësirë për t'u zhvilluar një projekt strategjik? Do të shpallej një konkurs ndërkombëtar, sepse asnjë qeveri nuk ka ekspertizën e duhur për projekte të tilla, dhe do të kërkonte të konkurronin agjenci me ekspertizën më të avancuar dhe të përzgjidhej projekti. Më pas vjen investitori, i cili sërish shpall një konkurs ndërkombëtar dhe e bën të njohur në mediet më prestigjioze ekonomike si: The Economist, Bloomberg apo Financial Times e kështu me radhë. Cilën nga këto procedura ndoqëm ne, ju lutem?

Në shekullin e VI-të, Para Lindjes së Krishtit, një nga shtatë të urtët e Athinës, Bias Prienes, ka thënë: - “Demokracia është e shkëlqyer aty ku frika nga ligji është e barasvlefshme me frikën nga tirani”. Në vendin tonë qeveria nuk ka frikë nga ligji dhe kjo është fatkeqësia më e madhe. Qeveria e nëpërkëmb ligjin, e sfidon ligjin hapur dhe publikisht, në organin legjislativ. Zonja dhe zotërinj të nderuar, e kuptoni se ku është rrënja e së keqes? Vijnë në një aspekt tjetër. Ne festuam, ngritëm për të mos ulur kurrë flamurin e Bashkimit European në parlamentin tonë, brenda dhe jashtë. Kur ndodhi kjo, unë insistova që duhet të ndryshojmë rrënjësisht tani e tutje, të veprojmë, të mendojmë dhe të ndihemi europianë. Çfarë ndodhi me këtë projekt?

Kishim një sinjal të parë: Bashkimi European anuloi 28 milionë nga fondi i kreditimit për portin e Durrësit: pse ndodhi kjo? A mund të na japë njeri shpjegime nëse është një sinjal, një rastësi apo ishte e planifikuar? Zonja dhe zotërinj, Po krijoni një trekëndësh konfliktual me Bashkimin European: porti i Durrësit, vizat e arta, amnistia fiskale. Ju, që keni përgjegjësinë e vonesës 10-vjeçare në procesin e integritetit, sërish po na krijoni një kuadër përplasjesh. Nuk e keni kuptuar që e drejta europiane është e drejta e Shqipërisë tani e tutje dhe në bazë të saj ne duhet të orientohejmë në aktivitetin tonë politik dhe qeverisës. Apo mos vallë edhe këto janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën?

Zonja dhe zotërinj, ka shumë projekte në vendet e rajonit të Bashkimit European, anëtarë apo kandidatë. Kemi ndjekur procedurat që u janë përmbajtur ata në projekte të tilla. Nuk ka asnjë ngjashmëri. Ju jeni të mentalitetit: ne vendosim dhe urdhërojmë. Nuk mund të ndodhë kështu në demokraci. Çfarë ju kërkojmë? Ju kërkojmë sqarim. Në vend të na e dini për nder që ju japim rastin t’ju shpjegoheni qytetarëve të vendit, na fyeni dhe na ofendoni. Jeni të vetmit që zotëroni të vërtetën absolute. Por nuk do të zgjatëm shumë me këtë. Një projekt i tillë ka edhe shumë aspekte të tjera, në dukje dytësore, por, në fakt, janë shumë të rëndësishme. Ku do të zhvillohet ky projekt? Do të zhvillohet në Durrës. Durrësi është i shquar për site arkeologjike, për gjetje jashtëzakonisht të rëndësishme për trashëgiminë kulturore të vendit.

Në muajin gusht, gjatë rindërtimit të shkollës “Eftali Koçi”, në sitin e atjeshëm u gjetën gjetje me shumë rëndësi arkeologjike dhe gjurma e ndërtimit të shkollës u zhvendos. A keni parashikuar çfarë do të ndodhë me këto gjetje në Durrësin e trashëgimisë së lashtësisë në këtë projekt, që na e sillni me këtë ngut për t’u miratuar, apo do të ndiqni përvojën e deritanishme, që i betonizoni, duke varrosur ato dhe civilizimin që ato mishërojnë një herë e përgjithmonë? Zonja dhe zotërinj, Jemi në kushtet e një realiteti të ri për vendin tonë. Mos u ngutni!

Investitori aty është, edhe investimet aty janë, por ka rëndësi të mos vëmë karrocën përpara kuajve, të mos improvizojmë, sepse në vend të sjellim efektet pozitive që kërkohen, do të bëjmë të kundërtën, ndaj do t'ju lutesha të tregoni përgjegjshmëri, sepse mirëkuptim ndaj nesh nuk pres të tregoni! Tregoni përgjegjshmëri ndaj popullit, përgjegjshmëri ndaj ekonomisë së vendit, ndaj trashëgimisë së vendit dhe jepni edhe një shans tjetër debati dhe transparence! Asgjë e keqe nuk mund të vijë nga transparencja; nga ngutja dhe nga mungesa e saj vjen rezultati i kundërt nga ai i dëshiruari, pavarësisht se personalisht, nuk jam i sigurt për dëshirat dhe planet tuaja të vërteta. Faleminderit!